



Nr. 46 Prot.

Tiranë, më 12/03/2018

Drejtuar: **MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**  
Znj. Lindita NIKOLLA  
Ministër

Lënda: Kërkesë për hapjen e programit të ciklit të tretë, Master Ekzekutiv në "Menaxhim Financiar."

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin Nr. 31, datë 29.12.2017 "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Universiteti European i Tiranës ju paraqet kërkesën për hapjen e programit të ciklit të tretë:

**Master Ekzekutiv në "Menaxhim Financiar"**, me profile:

- a) Drejtim Financiar dhe Kontroll i Brendshëm;
- b) Auditim dhe Raportim Financiar;
- c) Strategji e Qeverisjes së Korporatave;
- d) Menaxhim Portofoli;
- e) Politikat Publike dhe Buxhetore.

Ky program studimi është hartuar në kuadër të projektit "Menaxhimi Financiar, Kontabilitet dhe Kontrolli - Zhvillimi i Kurrikulave për Ngritjen e Kapaciteteve të Administratës Publike" (FINAC), financuar nga Bashkimi European, Erasmus+ Aksioni Kyç 2 mbi Rritjen e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë (me numër reference: 573534-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP), fokusi kryesor i të cilit është të japë një kontribut për të rritur cilësinë e buxhetimit, menaxhimit të parasë, menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në Administratën Publike në Shqipëri dhe Serbi.

Objektivat specifike të këtij projekti janë: (i) të hartojë dhe zhvillojë tre programe të reja Master në Serbi dhe dy programe të reja Master në Shqipëri në fushat e menaxhimit financiar, kontabilitetit dhe kontrollit në Administratën Publike në Shqipëri dhe Serbi; (ii) të ofrojë trajnime në Qendrat Universitare/Institutë për punonjësit e Administratës Publike në Serbi e Shqipëri; (iii) Modernizimi i njërit prej programeve Master në fushën e Menaxhimit Financiar Publik në Serbi.


Ky projekt do të japë një kontribut në kontrollin e procedurave dhe rritjen e nivelit të transparencës së financës dhe kontabilitetit në Administratën Publike, çka korrespondon me prioritetet kombëtare dhe parimet e pranimit në BE të vendeve të rajonit. Partnerët e projektit janë: Universiteti i Beogradit (Serbi), Universiteti European i Tiranës (Shqipëri), Universiteti i Kragujevac (Serbi), Universiteti Shtetëror i Novi Pazar (Serbi), Universiteti Singidunum (Serbi), Ministria e Administratës Publike dhe Qeverisjes Lokale, Beograd (Serbi); Qendra për Politika Edukimi (Serbi); Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", (Shqipëri); Universitetit i Splitit (Kroaci); Universiteti Marconi (Itali); Universiteti Masaryk (Republika Çeke); Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin Matej Bel (Sllovenski).

Bashkëlidhur dokumentacioni i nevojshëm (i printuar dhe kopje elektronike në CD).

Mbetemi në dispozicionin tuaj për çdo plotësim të nevojshëm të dokumentacionit të paraqitur.

Duke ju faleminderuar për bashkëpunimin.

REKTORI





Tirane, 12/03//2018

To: **MINISTRY OF EDUCATION, SPORTS AND THE YOUTH**

Mrs. **Lindita NIKOLLA**

**Minister**

**Subject: Request for the opening of the third cycle program, Executive Master in Financial Management."**

Based on the Law No. 80/2015, dated 22.07.2015, "On Higher Education and Scientific Research in Higher Education Institutions in the Republic of Albania", Instruction No. 31, dated 29.12.2017 "For the determination of the criteria, documentation and the procedures for the opening, reorganization and closure of the study programs by the Higher Education Institutions ", the European University of Tirana submits its application for the opening of the third cycle program:

Executive Master in "Financial Management", with the following profiles:

- a) Financial Management and Internal Audit;
- b) Audit and Financial Reporting
- c) Corporate Governance Strategy;
- d) Portfolio Management;
- e) Public and Budget Policies


This study program has been developed within the framework of the project "Financial Management, Accounting and Control - Development of Public Administration Capacity Building Curriculums" (FINAC), funded by the European Union, Erasmus + Key Action 2 on Capacity Building in Higher Education ( with reference number: 573534-EPP-1-2016-1-RS-EPPKA2-CBHE-JP), which main focus is to contribute to increasing the quality of budgeting, cash management, financial management, accounting and control in the Public Administration in Albania and Serbia.

The specific objectives of this project are: (i) to design and develop three new Master programs in Serbia and two new Master programs in Albania in the areas of financial management, accounting and control in the Public Administration in Albania and Serbia; (ii) to offer training at the University / Institution Centers for Public Administration Employees in Serbia and Albania; (iii) Modernization of one of the Master Programs in the field of Public Financial Management in Serbia.

This project will contribute to the control of procedures and increase of the level of financial and accounting transparency in the Public Administration, which corresponds to the national priorities and the EU accession principles of the regional countries. The project partners are: University of Belgrade (Serbia) , European University of Tirana (Albania), University of Kragujevac (Serbia), State University of Novi Pazar (Serbia), Singidunum University (Serbia), Ministry of Public Administration and Local Governance, Belgrade (Serbia); Center Education Policies (Serbia); University of Shkodra "Luigj Gurakuqi (Albania); University of Split (Croatia), Marconi University (Italy), Pasaryk University (Czech Republic), Faculty of Economics at Matej Bel University (Slovakia) .

Please find attached the required documentation (in hardcopy and soft copy on CD).

We remain at your disposal for any necessary supplementation of the submitted documentation.




Thank You for Your cooperation.

RECTOR

Prof. Dr. Tonin GJURA

/signature and seal/

UET, Licensed by DCM dated 20.09.2006, Accredited by the Decision of the Accreditation Board no. 12  
date: 07.04.2017



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTERISE TIRANE  
Nr. 1743 Rep.

Tirane, me 13.03.2018



VERTE TIM

Vërtetohet firma e përkthyesës së gjuhes Angleze Znj. Anila Myftaraj (Binaj), e njohur personalisht prej meje noterit, e cila deklaroj se përktheu dokumentin bashkangjitur ne mënyre autentike nga gjuha Shqipe ne gjuhen Angleze dhe nënshkroi rregullisht sipas ligjit.

NOTER  
JULIAN ZHELEGU



REPUBLIC OF ALBANIA  
TIRANA CHAMBER OF NOTARIES  
No. 1743 Rep.

Tirana, on 13.03.2018

ATTESTATION

I do hereby certify the signature of translator of English Language Ms. Anila Myftaraj (Binaj), known personally by me, the notary, who declared that has translated authentically the document attached from Albanian Language to English language and she signed based in law.

NOTARY PUBLIC  
JULIAN ZHELEGU